

Mbi

Auditimin e Brendshëm

Ushtruar në Shtëpinë e Femijës 6-18 vjeç

Njesia e Auditimit Brendshem – Bashkia Shkoder bazuar ne ligjin 114/2015 “Per Auditimin e Brendshem ne sektorin publik”, VKM nr 212 date 30.03.2012 “Per miratimin e kriterëve per ngritjen e Njesive te Auditimit te Brendshem ne sektorin publik”, zhvilloi

nje mison auditimi te plote ne Shtëpinë e Femijës 6-18 vjeç per periudhen 01.01.2015 - 31.12. 2016,ku nga auditimi rezultoi:

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

Njësia e Auditimit të Brendshëm- Bashkia Shkodër, auditoi Shtëpinë e Femijës 6-18 vjeç. Gjatë Kryerjes se misionit te auditimit jane konsttuar mangesi ne percaktimin e rregullave dhe normave te organizimit punes dhe menaxhimit te institucionit, ka mangesi ne administrimin e shpenzimeve , kryesisht ne procedurat e prokurimit dhe ne llogaritjen e pagave , ka mangesi ne menaxhimin e aseteve si dhe ne menaxhimin e standarteve si institucion perkujdesje per femijet ne nevoje.Ka munguar deklarata e misionit, nuk eshte ngritur sistemi i monitorimit , ka mangesi ne raportim sipas hirerarkise. Per permiresimin e punes jane lene rekomandime sipas gjetjeve te konstatuara.

GJETJET DHE REKOMANDIMET

1.Gjetje: Ka mangësi në perpilimin dhe miratimin e rregullores së brendëshme, nuk jane percaktuar pergjegjesiste sipas linjave te raportimit, nuk eshte ngritur grupi i menaxhimit strategjik, nuk eshte perpiluar deklarata e misionit, vizionit dhe objektivave, mungon regjistri i riskut, nuk jane percaktuar procedurat e brendeshme te sinjalizimit parregullsive dhe antikorrupsionit .

Rekomandim

a. Përshtatjen e rregullores se brendshme në perputhje me ligjin nr. 10296 date 08.07. 2010“Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, detajimin ne menyre analitike te te gjitha aktivitetëve qe kryen cdo punonjes, detajimin e sistemit të kontrollit sipas aktivitetëve, miratimin e rregullores nga Kryetare e Bashkisë. (sipas modelit të rastit studimor nr. 03 të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit).

b. Përcaktimin e objektivave te institucionit, vleresimin e mundesise së ndodhjes se ngjarjeve, *si dhe perpilimin e regjistrit te rriskut*, sipas modelit të rastit studimor nr. 04 të manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

c. Ngritjen dhe funksionimin e Grupit menaxhimit strategjik, ku ne perberje te jene drejtuesit kryesore te institucionit.

d. Vendosjen e procedurave te brendëshme te sinalizimit parregullsive dhe antikorrupsionit .

2.Gjetje. Ka mangesi ne ngritjen e sistemit te monitorimit, kryerjen e procedurave te monitorimit , ngritjen e sistemit te informimit dhe kryerjen e procedurave te informimit.

Rekomandim: Ne rregullore ne institucionit te parashikohen procedurat e sistemit te monitorimit dhe informimit, bazuar dhe ne manualin e menaxhimit financiare dhe kontrollit.

3.Gjetje: Nuk është bërë përshkrimi i vendeve te punes sipas detyrave funksionale, nuk është kryer menaxhimi i rriskut , nuk ka asnje punonjes me diplome te sherbimeve sociale,nuk eshte bërë plan per kualifikimin e punonjesve.

Rekomandim: Te perpilohen dhe te miratohen pershkrimet e punës për të gjithë punonjesit.

4.Gjetje: Ka mangesi ne miratimin e perpilimin e gjurmes auditit per zbatimin e buxhetit .

Rekomandim: Te kerkohet me shkrim, prane Drejtorise Planifikimit buxhetit ne Bashki per te marre asistencen e nevojshme per perpilimin e zbatimin e gjurmës auditit per buxhetin.

5.Gjetje: Kane perfituar pagese per veshtersi ne pune per vitin 2014 , mesatarisht 15 punonjes per vlere 789.527 lek dhe per vitin 2015, kane perfituar pagese per veshtersi ne pune , mesatarisht 15 punonjes per vlere 700.166 lek ne total 1.489.693 lek.

Rekomandim: Llogaritjen e kryerjen e ndalesave per veshtersi per te gjithë punonjsit që kane përfituar sipas raportit auditimit.

6.Gjetje: Ka mangesi ne ndjekjen e procedurave standarte sipas kerkesave te pikave 140-145 te udhëzimit nr. 02 date 06.02.2012 “Për procedurat standarte te zbatimit buxhetit” i ndryshuar.,ka mangesi ne percaktimin e specifikimeve teknike, ne perpilimin e gjurmeve te prokurimit dhe kryerjes se shpenzimit, ka mangesi ne evidentimin dhe ndjekjen e kalendarit te levrimit te mallit.

Rekomandim :Te merren masa per kualifikimin e personelit që organizon prokurimet publike .

7.Gjetje. Ka mangsi te theksuara ne evidentimin dhe administrimin e aseteve, ne marrdheniet me donatoret e ndryshem, ne plotesimin e dokumentacionit aseteve, ne evidentimin e normave te harxhimit dhe llogaritjes karburantit.

Rekomandime

a.Ne bashkepunim me drejtuesit e bashkise te behet kualifikimi i punonjesve te ngarkuar per menaxhimin e aseteve sipas rregullores menaxhimit aseteve te miratuar nga Kryetare e Bashkise Shkoder .

b.Te behet ri inventarizimi i pasurise bazuar ne dokumentet ligjore, si dhe te behet rivlersim i inventarit, bazuar ne vitet e perdorimit, dhe gjendjen aktuale.

c. Ngritjen e komisionit me specialiste perkates per percaktimin e normes karburantit per mjetet e transportit, si dhe rillogaritjen e karburantit per distancat e pershkuara , bazuar ne urdherin e ministrise Transportit nr. 125 date 26.12.2011 “Per distancat e kilometrave ne qytete.Diferenca te zhdetohet nga personat pergjegjes.

8.Gjetje.Ka mangesi ne percaktimin e rregullores se menaxhimit te jetes se femijeve ne qender, ne pranimin bazuar ne objektiva, ne monitorimin e aktiviteve.

Rekomandim: Hartimin e rregullores menaxhimit perkujdesjes, bazuar ne objektivat e qendres, percaktimin e kriterëve specifike te pranimi, percaktimin e normave te sjelljes, normave te edukimit, normave te qendrimit, normave te levizjes brenda dhe jashte qendres.

Njesia Auditimit Brendshem

Bashkia SHKODER